



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 20, datë 28.04.2015

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E NDALIMIT OSE
KUFIZIMIT TË PËRDORIMIT TË LIRË TË AKTIVEVE TË SHOQËRISË SË
SIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 153, pika 1, germa ë), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për procedurat e ndalimit ose kufizimit të përdorimit të lirë të aktiveve të shoqërisë së sigurimit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI